



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të dëgjimit publik lidhur më Projektregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, mbajtur më 30.10.2024.

Në mbledhje morën pjesë: Ramadan Beshiri, Rudina Hasimja, Kastriot Orana, Fidan Shatri, Enis Haziri, Fisnik Juniku dhe Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Lindita Hajdari, udhëheqëse e Sektorit të kulturës dhe Granit Makolli, zyrtar nga Drejtoria e Sportit në Kryeqytet.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**.

Osman Bllaca përshëndeti të pranishmit, duke thënë se diskutimi i sotshëm ka të bëjë me Projektregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës. Ai tha se të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që do të bëhen sot nga ju, do të merren parasysh dhe do të inkorporohen në këtë projektregullore.

Kastriot Orana, qytetar, nga sporti i Pingpongut, tha se a kemi mundësi që kriteret të cilat kërkohen për aplikim për ndarjen e subvencioneve të përfshihen edhe në projektregullore. Si shembull, në kriteret e ndarjes së subvencioneve nga Drejtoria e Sportit, mund të merren parasysh të hyrat vjetore të klubeve dhe mos të përkrahen ato klube që presin këto subvencione vetëm sa për mbijetesë.

Osman Bllaca theksoi se kriteret e aplikimit në ndarjen e subvencioneve caktohen nga drejtoritë përkatëse me rastin e njoftimit për hapjen e kohës së përcaktuar për aplikim, ndërsa për shumën e mjeteve për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Sportit, duhet të merret për bazë Rregullorja nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Ne kemi mbajtur takime me ta dhe kemi propozuar disa ndryshime të kriterëve në këtë rregullore, pasi që të njëjtat na penalizojnë edhe neve si nivel komunal, por deri tani nuk kemi asnjë ndryshim.

Ramadan Beshiri, qytetar, tha se si kriterë për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Sportit, është mirë të merret parasysh puna dhe rezultatet e arritura nga ato ekipe.

Rudina Hasimja, qytetare dhe hulumtuese në KCSF, u shpreh se duke marrë për bazë Rregulloren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kufizimi i ndarjes së shumës bëhet vetëm për rastet kur ndarja bëhet me Vendim të Kryetarit, shumë kjo e cila nuk mund ta kalojë vlerën më të madhe se 500 euro për një OJQ. Duke marrë parasysh që e kemi një vit të kufizuar për ndarjen e këtyre mjeteve të cilat i përfitojmë nga niveli lokal apo qendror, janë tepër të ulëta dhe kemi vështirësi të shumta që vetëm me këto të mbijetojmë si klubet sportive, ashtu edhe OJQ-të.

Blerand Stavileci, qytetar, tha se duke u bazuar në këtë projektregullore, Rregulloren e vjetër dhe Rregulloren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, nr. 04/2017, duken nganjëherë se më shumë punohet të jenë faktike, pra reale, se që mundohen të bëjnë zgjidhje në rregullimin e problemeve dhe këtyre çështjeve që ne po i përmendim këtu. Ai i njoftoi të pranishmit për disa raste, të cilat ai është ndeshur vetë me Ligjin për parandalimin e zyrtarëve publikë sa ishte edhe pjesë e stafit. Për këtë projektregullore, duke i dëgjuar edhe parafolësit për të njëjtat problematika, tha se do dëshironte ta diskutonin nenin 5, në mënyrë që ta gjejmë një zgjidhje sa më të mirë, që mos të kemi përfitues vetëm një grup të caktuar. Stavileci tha se respekton të gjitha klubet e sporteve të të Prishtinës, por me theks të veçantë, besoj se ato klube të cilat e mbajnë vet emrin “Prishtina”, të kenë jo ndonjë trajtim më të veçantë për këtë arsye, por besoj se mbi vete mbajnë një përgjegjësi më të madhe sociale, kulturore dhe sportive. Mbi këtë projektregullore, në veçanti për ndarjen e subvencioneve në Sport, përveq kriterëve me të cilat dalin nga drejtoria, kjo ndarje duhet të bëhet edhe duke i shikuar gjatë kësaj kohe arritjet e klubit në gara vendore apo ndërkombtare, raporteve nga të hyrat financiare, raportet të auditimit etj.

Osman Bllaca theksoi se ne si Kuvend i Kryeqytetit tash e sa vjet kemi ndarë shuma, të cilat kanë ardhur me kërkesa nga klubet e ndryshme të qytetit. Por në raportin e audimit, auditori i jashtëm e ka shënuar si të gjetur dhe thotë që të respektohet parimi i parë i nenit 4, të pikës 1.1, e cila është konkurrueshmëria, dhe pas kësaj kemi përgjigjen negative nga MAPL rreth konfirmimit të ligjshmërisë së këtyre vendimeve. Ai tha se poashtu kemi ndryshime të neni 7, i kësaj projektregulloreje, në themelimin, përbërjen, kohëzgjatjen dhe mandatin e komisioneve për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.

Blerant Stavileci shprehu mendimin se këto probleme janë të njëjtat me ato të cilat ndodhin edhe në Ministrinë e Kulturës dhe Sportit, por besoj se duhet të dalë ndonjë dhe t’u shpjegojë dhe jo të ndodhë penalizimi i klubeve sportive vetëm pse janë të regjistruara si OJQ, e në fakt aktiviteti i tyre është krejt ndryshe.

Fidan Shatri, qytetar, u shpreh i pajtimin me parafolësin për të gjitha pengesat dhe problemet që shfaqen nga auditorët e jashtëm. Besoj se e vetmja zgjidhje e këtyre problemeve është implementimi i këtyre kriterëve bazike, të cilat i biseduam lidhur me këtë projektregullore dhe në të ardhmen të merret si bazë e Vendimit për ndarjen e subvencioneve, p.sh. nga Drejtoria e Sportit, apo edhe kur të bëhet thirrja për njoftimin.

Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit, përshëndeti të pranishmit, duke i falënderur për pjesëmarrje në këtë diskutim dhe u premtoi që së bashku do përpiqemi ta bëjmë më të mirën. Ai shtoi se mjetet që federatat i pranojnë nga Ministria e Kulturës dhe Sportit, i marrin vetëm për mbarëvajtje dhe për pjesëmarrje. Ndërsa sa i përket bashkupunimit në mes të Komunës dhe Ministrisë së Kulturës dhe Sportit, është pak i ngathët në të dy anët.

Blerand Stavileci, qytetar, tha se zgjidhja e problemit në të gjeturat e auditorëve nuk është vetëm vendosja e këtyre kriterëve në këtë projektregullore. Mendoj se problemi është më i madh, sepse ne nuk mundemi që pas një kohe në rast se vjen ndonjë zyrtar tjetër i auditimit dhe pranojmë prapë kërkesë që të ndryshojmë kriteret.

Kastriot Orhana, qytetar, tha se ne kemi pasur rastin ku kemi pranuar njoftimin për mbajtjen në dhjetor të turneut të ping-pongut “Europe Trophy”, dhe nuk kemi mundur të aplikojmë si organizator pa pasur mbështetjen edhe nga Komuna.

Blerand Stavileci, qytetar, tha se në qoftë se do të kishte ekzistuar mundësia që në këto raste kur bëhet thirrja për ndarjen e subvencioneve në sport, posht bazës së Vendimit të theksohet se nuk vlen kriteri i konkurrueshmërisë.

Fidan Shatri, qytetar, tha se deri në dhjetor të këtij viti do të hartohet edhe Rregullorja e përgjithshme e financimit të klubeve, e cila besoj se do të krijojë shumë zgjidhje për këto probleme. Ai tha se shumë shpejt do ta kemi në diskutim publik dhe do të kemi mundësinë që të gjithë të japim kontribut, që të dalim me diçka sa më të mirë për sportin e Kryeqytetit.

Rudina Hasimja, qytetare, tha se problemi kryesor është regjistrimi i të gjitha OJQ-ve, si ato sportive, ashtu edhe ato të shërbimeve me një fond të regjistruar si subjekte juridike. Ajo shtoi se qfarë u kërkua më heret që të bëhet një lloj trajtimi më ndryshe për disa ekipe, mendoj se është një kriter i gabuar, pasi që në një të ardhme mund të merret si diçka jo pozitive. Ajo tha se mënyra më e mirë është ashtu siç është cekur në këtë projektregullore, që drejtoria përkatëse ta bëjë vlerësimin e nevojave në çdo fillim vitë, ta bëjë ndarjen në disa kategori dhe të dalin me kriterë sa më të mira për të gjithë, pa ndonjë dallim.

Osman Bllaca theksoi se në të kaluarën ne kemi bërë ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Sportit deri tri herë gjatë vitit, por ne së bashku me drejtorinë kemi

menduar që ndoshta më mirë është të bëhet një herë gjatë vitit, por shumat të jenë më të larta.

Fisnik Juniku, nga “3x3 Prishtina”, tha se sugjerimi ynë për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Sportit, është që ndarja e mjeteve të bëhet në fillim të vitit dhe jo në mes apo në fund, për arsye të dakordimeve rreth organizimit me “Fiba”, njoftimeve sa më të hershme dhe të dalim me një organizim sa më të mirë. Ai tha se për neve kanë ndikim shumë të madhë këto mjete, për shkak edhe të hezitimit për mbështetje nga spozorët e ndryshëm, pasi që koha e reklamimit të bizneseve është vetëm katër ditë sa zgjasin edhe garat .

Blerand Stavileci tha se mbetemi me shpresë se ato probleme, ato sugjerime të cilat ne bashkë sot i diskutuam këtu, të merren parasysh dhe të dalim me një Rregullore sa më të mirë dhe më të përshtatshme për të gjithë, dhe jo prapë nesër të ndeshemi me probleme të kësaj natyrave, siç është konkurrueshmëria.

Rudina Hasimja shtroi pyetjen lidhur me nenet 5 dhe 30, paragrafi i parë, pika c), ku thuhet se subvencionohen fusha të caktuara, të cilat kalojnë vlerën prej tridhjetë mijë euro, pse është vendosur ky limit. Ajo pyet se çfarë ndikimi ka ndarja e kërkesave të veçanta, të cilat shkojnë te kryetari dhe kanë trajtim nga komisioni.

Osman Bllaca u shpreh se kjo projektregullore ka një përfshirje më të gjerë, pra këto nene kanë të bëjnë me ndarjet e mjeteve për ndërmarrjet publike, por besoj se do ta krijojmë edhe një definicion më të qartë për këto fusha.

Bllaca i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe i rekomandoi prapë që të gjitha këto probleme që i cekëm, kritika apo sugjerime të tjera, të dërgohen në formë të shkruar që të dalim me një Rregullore sa më të mirë për të gjithë.

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Kryesues i mbledhjes
Osman Bllaca



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

Diskutim publik lidhur me projektregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 30 tetor, 2024 Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal					
Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	REZVAN BESHTARI	BESHTARI			
2	Rudina	HASIMJA			
3	KASTRUC	OSMANI			
4	FILIPAN	SHATAJ			
5	Enis	HAFIZI			
6	FISNIK	JUNIKU			
7	Blerand	STANI			
8					
9					
10					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!